

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare (Neni 5), Ligji nr. 04/L- 143 për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës (Neni 9,10,14.16,17,18,19), Ligji nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (Neni 18),UA 32/2014 mbi kriteret dhe procedurat për sigurim të cilësisë në institucionet e AAP-Proceset e brendshme (Neni 3, 4, 5 dhe 6), Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (KKK). dhe në bazë të të Rregullores mbi Rregullat dhe procedurat për siguri të cilësisë të Institucionit Melita&Partners lidhet kjo:

K O N T R A T Ë
PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATIT NË INSTITUCIONIN MELITA&PARTNERS, PËR VIJIMIN E
TRAJNIMIT PËR NËPUNËS KONTABILITETI, I AKREDITUAR NGA AUTORITETI KOMBËTAR I
KUALIFIKIMEVE SIPAS VENDIMIT numër 01/308 të datës 13.05.2024

Në mes:

I. Institucionit Melita&Partners me seli në Prishtinë, Rruga Tirana nr. 31, Lakrishte, Objekti Arting Kati XII, Nr 33, me numër unik identifikues 810198300 të cilin e përfaqëson znj. Melita Ymeraga – Drejtore Ekzekutive *(në tekstin në vijim: Ofruesi i trajnimeve)*

dhe

II. **Emri dhe mbiemri** me Nr. Letërnjoftimi **numri i letërnjoftimit** *(në tekstin e mëtejshëm: përfituesi i trajnimit)*.

Neni 1. Objekti i Kontratës

Në këtë kontratë, përcaktohen kushtet themelore për regjistrimin e kandidatit, të drejtat dhe detyrimet e palëve lidhëse për zbatimin e programit edukativ kualifikues për Nëpunës Kontabiliteti, si dhe detyrimet për respektimin e rregullave etike nga kandidati i regjistruar.

Neni 2. Regjistrimi dhe Kushtet e Regjistrimit

2.1 Përfituesi i trajnimit është regjistruar për vijimin e trajnimeve në nivelin Nëpunës Kontabiliteti i akredituar me 26 kredi.

2.2 Përfituesi i trajnimit është regjistruar për afatin e Prill 2025, brenda të cilit afat duhet të vijoj trajnimet, të paraqesë dhe të paguajë tarifën përkatëse para hyrjes në secilin provim në periudhën e caktuar pas përfundimit të trajnimeve.

2.3 Kandidati i regjistruar nuk ka të drejtë transferimi të trajnimeve në afatet e tjera. Në rastet e ndërprerjes së trajnimeve nga kandidati mbeten në fuqi detyrimet financiare, në mënyrën e përcaktuar me nenin 5 të kësaj Kontrate.

2.4 Shuma financiare për pagesë është **cmimi i trajnimit** Euro për vijimi të trajnimit **formen e trajnimit**.Pagesa është e ndarë në 4 këste të barabarta (shuma e kështit).

Neni 3. Detyrat e Ofruesit të Trajnimeve

3.1 Ofruesi i trajnimeve ka për detyrë të organizoj trajnimet e përcaktuara për këtë nivel bazuar në Konkursin e publikuar të 5 Mars 2025 për Regjistrimin e Studentëve për Afatin,Prill 2025.

3.2 Melita&Partners ofron organizimin e trajnimeve konform planeve dinamike të ligjëratave për afatin e Prill 2025.

3.3 Melita&Partners pas përfundimit të secilit modul, organizon afatin për provim modular. Tarifat e provimeve nuk përfshihen në faturë ato janë kosto e veçantë të cilën duhet ta paguaj kandidati që nga paraqitja e provimeve për herë të parë. Paraqitja e provimeve bëhet sipas procedurave të Melita&Partners, kurse pagesa e tarifës së caktuar për provime duhet të bëhet brenda afatit zyrtar të publikuar. Tarifa për provime caktohet sipas çmimoreve e cila është publike dhe e njohur për kandidatin.

3.4 Kandidati i regjistruar në afatin e Prill 2025, regjistrimin e provimit për herën e parë në afatin e parë të provimeve e ka falas.

3.5 Kandidati i regjistruar në afatin Prill 2025, përfiton anëtarësinë vitin e parë falas. Më tutje anëtarësia paguhet në baza vjetore.

3.6 Me përfundimin e ligjëratave dhe kalushmërinë e të gjitha provimeve, kandidati duhet të plotësojë komplet dosjen e tij me të gjitha dokumentet sipas kërkesave për Certifikim, nga ana e Melita&Partners dhe vetëm pas plotësimit të të gjitha kriterëve dhe përbushjes së detyrimeve financiare, përfituesi pajiset me certifikaten për titullin kualifikues “Nëpunës Kontabiliteti”, një titull që i siguron studentit 26 kredi ECTS. Çertifikata nuk i ipet kandidati, nëse nuk e paguan paraprakisht anëtarësinë vjetore.

Neni 4. Të Drejtat e Përfituesve të Trajnimeve

4.1 Përfituesi i trajnimeve, pas përfundimit të ligjëratave për afatin e regjistruar mund t'i nënshtrohet provimeve për secilin modul sipas orarit të përcaktuar.

4.2. Kandidati për të pasur mundësi të hyjë në provime duhet ta paraqet provimin sipas procedurave të Melita&Partners, dhe të bëjë pagesën sipas paragrafit 3.3 të neni 3 të kësaj Kontrate.

4.3 Me përfundimin e zbatimit të paragrafit 4.1 dhe 4.2 të këtij neni, përfituesi mund të hyjë edhe në provimet e mbetura apo të pa-kaluara sipas kushteve të përcaktuara me aktet nënligjore të Institucionit duke e përfshirë pagesën e rregulltë vjetore të anëtarësisë dhe pagesën e tarifës së caktuar për hyrje në provim. Hyrja në provime nuk lejohet nëse kandidati i ka mbetë borxh Institucionit në çfarëdo shume.

Neni 5. Kompenzimi i Shpenzimeve për Trajnim

5.1 Përfituesi i regjistruar për trajnim “Nëpunës Kontabiliteti”, me lidhjen e kësaj kontrate obligohet të paguaj shumën e caktuar në përputhje me shumën e prezentuar në profaturën/faturë e cila i dorëzohet kandidati, qoftë online përmes emailit apo fizikisht. Cilado formë e dorëzimit të faturës ka efektin e njëjtë dhe për këtë shkak nuk mund të kontestohet nga palët.

5.2 Palët mund të mirren vesh për pagesën e shumës së përgjithshme ose në këste, por jo më shumë se 4 këste mujore. Kësti parë paguhet me regjistrim kurse këstet tjera në baza mujore, sipas faturës së pranuar nga ana e kandidati. Këstet dhe shumat e përcaktuara në faturë kanë fuqinë dhe efektin e njëjtë si pjesë integrale e kësaj Kontrate.

5.3 Kostoja standarde e pagesës për regjistrim përfshinë: trajnimin, literaturën, pagesën e anëtarësisë. Pagesa e anëtarësisë vlen përgjatë kohës së hyrjes në provime dhe përfundon në momentin e plotësimit të kushteve për dhënien e Certifikatës. E tëra kjo periudhë nuk mund të jetë më e gjatë se një (1) vitë, ndërsa në momentin që ju përfundon anëtarësia duhet të paguhet anëtarësia vjetore 50.00€ si anëtar student, ndërsa pas certifikimit anëtarësia vjetore kushton 50€. Edhe në rastet kur nuk kalon një (1) vit, anëtarësia përfundon në momentin që kandidati i kalon të gjitha provimet dhe i plotëson kushtet për certifikim.

5.4 Pagesa e shumës sipas pikës 1 të këtij neni paguhet në xhirollogarinë bankare të Institucionit Melita&Partners, me detaje si mëposhtë :
Kompania: MELITA & PARTNERS SH.P.K.
Xhirollogaria Bankare: 2011000124831765
Emri i Bankës: TEB sh.a. Prishtinë, Kosovë
Adresa e Bankës: Agim Ramadani no.1

5.5 Me regjistrimin dhe nënshkrimin e kësaj kontrate, përfituesi i trajnimeve i ka detyrimet si në vijim:

5.5.1 Të kryej pagesën në tërësi;

5.5.2 Pagesa duhet kryhet në afatin kohor të përcaktuar në faturë, në të kundërtën kandidatit i ndërprehet çdo shërbim dhe anulohet çdo zbritje.

5.5.3 Pagesa e kryer nuk mund të akumulohet për kompensim të regjistrimeve të ardhshme, anëtarësi vjetore apo për hyrje në provime në afate të tjera jashtë kushteve të përcaktuara me këtë kontratë.

5.6 Në rast të ndërprerjes së trajnimeve, përfituesi nuk ka të drejtë në kërkesë për kthimin e mjeteve të paguara. Po ashtu, ai është i detyruar për pagesën e mjeteve të tjera, atëherë kur palët janë marr vesh për kryerjen e pagesës me këste, siç është përcaktuar në paragrafin 5.1 dhe 5.2 të këtij neni.

5.7 Në rast të mos përmbushjes së kësaj Kontrate dhe detyrimeve të pranuar nga kandidati, palët pajtohen që faturat që lëshohen nga Ofruesi i Trajnimeve, në bazë kësaj kontrate të përbëjnë dokument përmbarues, sipas ligjeve në fuqi dhe Ofruesi i Shërbimeve ka të drejtë që borxhin që mund të akumulohet ta realizoj në bazë të ligjit në fuqi për përmbarim.

Në raste të tilla barra e kompenzimit për të gjitha shpenzimet procedurale bie mbi kandidatin.

Neni 6. Detyrimet Tjera dhe Përgjegjësitë

6.1 Përfituesi i trajnimeve ka për obligim të respektoj parimet etike dhe normat e sjelljes të përcaktuara me aktet nënligjore të Institucionit Melita&Partners

6.2 Përfituesi i trajnimeve nuk duhet të keqpërdor apo të shpërndaj në mënyrë të pa-autorizuar materialet dhe të dhënat tjera të Institucionit Melita&Partners.

6.3 Përfituesi i trajnimeve mbahet përgjegjës për dëmet materiale dhe morale të shkaktuara ndaj Institucionit Melita&Partner me qëllim apo nga pakujdesia dhe të cilat bien ndesh me aktet nënligjore.

6.4 Përfituesi i trajnimeve pajtohet që Melita&Partners ka të drejtë të bëjë fotografimin dhe incizimin e ligjeratës dhe të kandidatëve, si dhe përdorimin e fotografive dhe incizimit për qëllime të promovimit të trajnimeve.

6.5 Përveç kësaj kontrate, përfituesi i trajnimeve e nënshkruan formularin e regjistrimit dhe deklaratën për njohjen e parimeve etike dhe detyrimeve të tjera që burojnë nga Kodi i Etikës dhe për respektimin e të gjitha detyrimeve të përcaktuara me aktet tjera të Institucionit Melita&Partners

Neni 7. Ndërprerja e Kontratës

7.1 Ofruesi i trajnimeve do ta ndërprejë para kohe kontratën në rast të shkeljeve të kushteve të përcaktuara me nenin 5 dhe 6 të kësaj kontrate.

7.2 Në rast të ndërprerjes së Kontratës sipas paragrafit 1 të këtij neni, përfituesi i trajnimit mbahet përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve sipas paragrafit nenit 5 të kësaj Kontrate.

Neni 8. Mospajtimet

8.1 Mospajtimet ndërmjet palëve zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet tyre.

8.2 Për shkeljet e kushteve të kësaj Kontrate dhe për të cilat palët nuk arrijnë pajtueshmëri, çështjet për shqyrtim dhe zgjidhje do të iniciohen në Gjykatën kompetente në Prishtinë sipas procedurave për marrëdhëniet e detyrimeve.

Neni 9. Zbatimi i Kontratës

9.1 Kjo kontratë do të zbatohet nga data e nënshkrimit të saj dhe deri në përfundimin e rregullt të afatit të ligjëratave dhe mbajtjes së provimeve për të cilin është regjistruar përfituesi.

9.2 Me përfundimin e afatit sipas paragrafit 1, të këtij neni, përfituesi i trajnimeve mund të vazhdojë të shfrytëzojë afatet tjera të provimeve në mënyrën e përcaktuar me aktet nënligjore të Institutit, duke përfshirë pagesën e provimeve.

9.3 Kontrata hartohet dhe nënshkruhet në dy kopje, nga një (1) për secilën palë.

9.4 Kjo Kontratë hyn në fuqi pas nënshkrimit elektronik nga palët lidhëse. Nënshkrimi elektronik i palëve bazohet në zbatimin përshtatshëm të dispozitave (nenit 1 dhe 6) të Ligjit Nr. 04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike.

Prishtinë, data e dites se nënshkrimit të kontratës

Për Institucionin: Melita&PartnersSHPK:
Melita Ymeraga, Drejtore Ekzekutive

Përfituesi i trajnimit:
Emri i përfituesit

(Nënshkrimi & Vula)

(Nënshkrimi)